



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.58, datë 27.12.2023

PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS
KANALIZIME VLORË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime" (**Vendim KKRR nr.539**),

Komisioni Kombëtar Rregullator

Në mbledhjen e datës 27.12.2023 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e UK Vlorë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, sipas kërkesës së shoqërisë me shkresën nr. 2257 prot. datë 29.09.2023, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura" dhe më pas me shkresën nr. 2336/1 prot. datë 06.10.2023, me lëndë "Saktësim i dokumentacionit për dosjen e aplikimit të tarifës", ka bërë plotësimet përkatëse sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe Vendimin nr. 539 të KKRR,

Konstaton se:

1. Paraqitja e kërkesës së shoqërisë UK Vlorë, për vendosjen e nivelit të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021. KKRR me Vendimin nr. 46, datë 10.11.2023 vendosi për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vlorë.
2. Shoqëria UK Vlorë sh.a ushtron aktivitetin e saj me tarifa të miratuara nga ERRU sipas vendimit të KKRR-së nr. 51, datë 28.10.2019 për bashkinë Vlorë. Me shkresë nr. 2257 prot. datë 29.09.2023, me lëndë "*Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të*

pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” Ujësjetllës Kanalizime Vlorë propozon nivelet tarifore fikse dhe volumetrike për secilin shërbim, sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1: Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria UK Vlorë

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara 2024
A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³
1. Konsumatorë Familjarë	45	60
2. Konsumatorë Publik	100	133
3. Konsumatorë Privat	100	133
B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³
1. Konsumatorë Familjarë	15	17
2. Konsumatorë Publik	25	28
3. Konsumatorë Privat	25	28
C. Për shërbimin e përpunimit e ujërave të zeza*	Lek/m³	Lek/m³
1. Konsumatorë Familjarë		10
2. Konsumatorë Publik		12
3. Konsumatorë Privat		12
D. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
1. Konsumatorë Familjarë	100	200
2. Konsumatorë Publik	150	400
3. Konsumatorë Privat	150	400

3. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a është e licencuar me vendimin e KKRR nr. 245, datë 02.06.2022, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a.” për kategoritë A, (Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik) dhe kategorinë C, (Për largimin e ujërave të ndotura) i ndryshuar. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a nuk është e licencuar për kategorinë D, (për trajtimin e ujërave të ndotura), për këtë arsye propozimi i shoqërisë për nivel të ri tarifor për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura nuk është marrë në konsideratë në këtë vendim.
4. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a në propozimin e saj për nivel të ri tarifor, nuk ka respektuar kriterin e përcaktuar sipas nenit 18 pika 5 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve UK, ku citohet se tarifa volumetrike për klientët jofamiljarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy) krahasuar me klientët familjarë.
5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:
 - a) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi i kostove operacionale.
 - b) Aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve.
 - c) Reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele të larta:
 - d) Përmirësim i cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë

- e) Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.
6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin e KKRR nr.539, datë 30.12.2021, ERRU ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit dhe në planin e biznesit.
7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Vlorë e kritereve të mëposhtme:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” të ndryshuar;
 - d) Kërkesave të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",
 - e) Orientimin drejt mbulimit të Kostove Operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;
 - f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;
 - g) Propozimin për miratimin e tarifave për të gjithë zonën për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, ERRU e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar analizës tekniko- ekonomike.
8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Vlorë :
- a. Të aplikojë urgjentisht pranë ERRU-së për licencim për shtimin e kategorisë D të shërbimit për trajtimin e ujërave të ndotura.
 - b. Instalimi i matësve në burim (bulk meter), si edhe në matësat familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes;
 - c. Të kryejë vlerësimin e “Ujit të Prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet;
 - d. Të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Vlorë, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientet privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

- e. Të trajnojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA:
- Të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2023 dhe 2024 e në vazhdim.
 - Të gjejë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit i cili shkakton humbje fizike në nivele të larta.
 - Të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimit të defekteve, për të minimizuar sa më shumë humbjet nga rrjedhjet.
- f. Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjet nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet.
- g. Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2024;
- h. Të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2024;
- i. Të ndër marrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si: monitorim i klientëve, ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, apo pagesa on-line;
- j. Të hartojë një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
- k. Të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si me poshtë;
- Të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m³ ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë;
 - Të hartojë një data basë me të gjithë konsumin e energjisë (bazuar tek matësit, faturat e energjisë etj.), duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos;
 - Të krahasojë dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim;
 - Të realizojë trajnime për efikasitetin e energjisë për stafin operativ.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriteve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballeshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”. Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a si më poshtë:

Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë UK Vlorë

Kategoria e Klientëve	Tarifa
A. Tarifa Volumetrike për Shërbimin FU	Lek/m³
1. Klientë Familjarë	60
2. Klientë Publik	120
3. Klientë Privat	120
B. Tarifa Volumetrike për Shërbimin KUN	Lek/m³
1. Klientë Familjarë	17
2. Klientë Publik	28
3. Klientë Privat	28
C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje
1. Klientë Familjarë	200
2. Klientë Publik	400
3. Klientë Privat	400

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2024 për UK Vlorë do të jenë:

Tabela 3: Objektivat e Treguesve të Performancës për vitin 2024 sipas ERRU

TKP	Nr.	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Objektivat e vendosura nga KKRR
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë	%	93.62
	1.2	Mbulimi me shërbimin me kanalizime	%	71.25
TKP Teknike	2.1	Uji Pa te Ardhura	%	65
	3	Niveli i Matjes	%	70
	4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë/popullsi	13.5
	5.1	Efikasiteti i Energjisë për ujin	kWh/m ³	0.77

	6	Efiçenca e Stafit	staf/1000 popullsi të shërbyer	2.01
Shërbimi ndaj klientit	7.1	Ankesat e Klientëve	%	6.29
	7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë përgjigje	%	14.11
	7.3	Ankesat e Klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	8.51
TKP Financiare	8.1	Norma Korrente e Arkëtimit	%	85
	8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	%	91.49
	9.1	Mbulimi i Kostove O&M	%	96.25
	9.2	Mbulimi i Kostove Totale	%	57

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh. a. do të jetë 0.77% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.
4. UK Vlorë detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore” brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.
5. Vendimi i KKRR nr. 51, datë 28.10.2019 “Mbi tarifën e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Vlorë sh.a” shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.02.2024 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2025.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani